**INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

**Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI MAJ 2026**

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti I kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e Përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 29.04.2026 | Une jam nje banor i shqetesuar sepse poshtë pallatit ku banoj ndodhet një restorant . Prapa restorantit kanë vendosur një bombol shumë të madhe si depozitë me gaz. Pas ankimit që i bëmë restorantit tani dhe e kane maskuar me llamarina. Por kjo nuk e eviton rrezikun por vetëm e fsheh atë. Ne si banorë jemi te shqetesuar sepse ketu here pas here mban dhe era gaz. Ju lutem të merrni masa imediate për të evituar ndonjë incident tragjik me pasojë jetë njerëzish. Me këtë mesazh do i adresohemi dhe policisë së shtetit,adresës së kryeministrisë dhe në media nëse ju nuk merrni masa së shpejti,pasi jemi shumë të shqetësuar. | 04.05.2026 | Referuar ankesës tuaj me Nr.3816 Prot, datë 29.04.2026, për shqetësimin e banorëve të një pallati, për vendosjen e një rëzervuari gazi (GLN) në ambjentet e jashtme pas një subjektit, ju bëjmë me dije se:<br>Nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e I.SH.T.I. më datë 29.04.2026 u gjet i instaluar një rezervuar mbitokësor GLN I vendosur ngjitur me murin e subjektit, i mbrojtur nga një kllëf metalik i fiksuar mbi asfalt.<br>Impjanti kishte të instaluar sensor të pranisë së gazit brenda dhe elektrovalvol bllokuese jashtë.<br>Nga ana e inspektorëve nuk u konstatua ndonjë rrjedhje ose prani e gazit (GLN) brenda dhe jashtë ambjenteve të subjektit.<br>Përfaqësuesi i subjektit deklaroi se nuk ka pasur informacionin e duhur për faktin se ky rezervuar duhet të ketë distanca të përcaktuara nga objektet si dhe nuk ka pasur asnjëherë ndonjë ankesë ose tërheqje vëmendje, nga banorët rreth kësaj çështje.<br>Subjekti u urdhërua të largojë menjëherë rezervuarin si dhe u këshillua të kalojë në përdorimin e bombolave deri në 25 kg seicila për të cilat nuk ka kufizime ligjore për distancat dhe volume, nga objektet përreth në atë hapësirë të jashtme.<br>Subjekti menjëherë mori masa për largimin e rezervuarit dhe instaloi sipas kritereve tekniko-ligjore në fuqi, brenda ditës bombola 4x25 kg të kolauduara, ju la detyrë dhe mbrojtja me skelet metalik të bombolave nga faktorë të jashtëm. | E plotë | 0 |
| **2** | 01.05.2026 | Ju shkruajmë nga platforma "Portali i Pagave".<br>Ju informoj se kemi publikuar një faqe informuese të dedikuar për institucionin tuaj, bazuar në të dhënat zyrtare të publikuara nga faqja juaj, programi i transparencës: https://www.portali-pagave.com/paga_teknik_industrial/<br>Qëllimi i kësaj faqeje është të ndihmojë qytetarët dhe vetë punonjësit të njihen me kalkulimin dhe përbërësit e pagës.<br>Do të kishim nderin sikur ta vizitonit.<br>Nëse vëreni ndonjë mospërputhje me pagat, do të ishim mirënjohës ta na tregoni që t'i korrigjonim. | 08.05.2026 | Në zbatim të Ligjit Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 410 datë 13. 05. 2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62 datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është institucion qëndror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë me kompetenca inspektimi.<br><br>Referuar përcaktimeve ligjore në fushën e komunikimit elektronik, ISHTI ka detyrim të shkëmbejë informacione dhe të raportojë me platforma dhe portale qeveritare/ zyrtare.<br><br>Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit në fuqi në fushën e informimit publik, ISHTI ka detyrim ligjor publikimin e informacioneve për publikun në faqen zyrtare të internetit, ndër to dhe Programin e Transparencës, ku paraqitet një tablo e qartë e funksionimit dhe organizimit të këtij institucioni.<br><br>Për të gjitha sa më sipër, ju informojmë se, ISHTI nuk mund të verifikojë informacionin e publikuar në platformën "Portali i Pagave", që ju administroni, për aq kohë sa ky portal funksionon si iniciativë private dhe jo si Portal shtetëror zyrtar. | E plotë | 0 |
| **3** | 06.05.2026 | A mund të kryej import të vajrave lubrikfikante një shoqëri me përgjegjsi të kufizuar? Apo duhet të jetë domosdo sh.a. për import të vajrave lubrifikante? | 06.05.2026 | Në përgjigje të kërkesës Tuaj, të dërguar me email, me datë 05.05.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 4014 Prot datë 06.05.2026, në të cilin kërkoni të informoheni se a mund të kryej import të vajrave lubrifikante një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe a duhet të jetë domosdo sh.a për importimin e vajrave lubrifikantë , ju informojmë si më poshtë:<br>Bazuar në Nenin 14 të ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, ju bëjmë me dije se veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të vendit a të importit, ushtrohet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë. Tregtimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera ushtrohet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqerive aksionare, pasi të jenë pajisur me licencë tregtimi, sipas përcaktimeve të VKM nr.970, datë 02.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017). | E plotë | 0 |
| **4** | 08.05.2026 | Në kuadër të ushtrimit të funksioneve institucionale, ndër të cilat përfshihen mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e pronësisë industriale, garantimi i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, kontrolli metrologjik, si dhe mbikëqyrja e detergjentëve të vendosur në treg, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.<br>Në zbatim të kuadrit ligjor për mbikëqyrjen e tregut, trupat inspektuese kanë nevojë për marrjen e mostrave të produkteve dhe dërgimin e tyre për analiza dhe testime laboratorike pranë laboratorëve të akredituar.<br>Për sa më sipër, lutemi të na vini në dispozicion informacion lidhur me:<br>Listën e çmimeve për testimin laboratorik të kategorive : "tekstil" dhe "detergjentë";<br>Parametrat dhe metodat e testimit që laboratori juaj ofron për këtë kategori produktesh;<br>Procedurat dhe kërkesat për pranimin dhe administrimin e mostrave;<br>Dokumentacionin shoqërues të nevojshëm për dorëzimin e mostrave;<br>Afatet e realizimit të analizave dhe kthimit të raporteve të testimit; | 11.05.2026 | Lidhur me kerkesat tuaja per proceduren qe ndiqet ne Laboratorin e Tekstilit prane Inspektoratit Shteteror Teknik dhe Industrial, ju sqarojme si me poshte :<br><br>Cmimi per cdo kampion qe analizohet ku perfshihen te gjithe treguesit e akredituar kushton 9000 lek/kampioni.<br>Per parametrat dhe metodat qe ndiqen per detergentet dhe tekstilin, ju lutem gjeni bashklidhur tabelen.<br>Duhet te paraqiteni prane protokollit te ISHTI-it me nje kerkese per analizim dhe kampionet qe doni te analizoni (sasia eshte ne varesi te kampionit, minimalisht 500ml te detergentet likuid dhe tek detergentet e ngurte 1 cope)<br>Kampionet shoqerohen vetem me nje kerkese e cila depozitohet ne protokoll bashke me kampionet.<br>Afati i realizimit eshte 5 dite pune. | E plotë | 0 |
| **5** | 08.05.2026 | Paraqes një ankesë lidhur me një problem serioz që po na shqetëson prej kohësh.<br><br>Në katin e parë të pallatit ku banojmë ushtron aktivitet një biznes i cili tregton byrekë dhe produkte gatimi. Ne jetojmë në katin e dytë dhe prej një kohe të gjatë kemi pasur shqetësime të vazhdueshme për aromat e rënda të gatimeve, sidomos të qepës, për shkak të mungesës së një sistemi të rregullt aspirimi.<br><br>Së fundmi situata është përkeqësuar ndjeshëm edhe nga aroma e fortë e gazit që përdoret për pajisjet e gatimit. Kemi komunikuar në mënyrë qytetare me pronarët e biznesit duke kërkuar të kontrollojnë pajisjet dhe instalimin e gazit, pasi nuk mund të hapim dritaret e banesës për shkak të erës dhe shqetësimeve që shkakton. Megjithatë, përgjigjja e pronarit ka qenë arrogante dhe refuzuese.<br><br>Problemi me erën e gazit konstatohet kryesisht në orët e mëngjesit, për rreth një orë deri në një orë e gjysmë, në momentin kur hapet biznesi dhe ndizen pajisjet e gatimit. Më pas situata duket se stabilizohet. Edhe bashkëshortja e pronarit ka pranuar se "diçka ka ndryshuar", duke pohuar se aroma i shkakton djegie të syve.<br><br>Për këtë arsye kërkojmë nga ana juaj një kontroll dhe verifikim sa më të shpejtë të kushteve të sigurisë dhe higjienës në këtë biznes, veçanërisht të instalimeve të gazit dhe sistemit të aspirimit. Ju lutem që inspektimi të kryhet në orët e mëngjesit, kur biznesi fillon aktivitetin, pasi vetëm në atë periudhë problemi evidentohet qartë. | 13.05.2026 | Në përgjigje të ankesës tuaj dërguar me e-mail dhe protokolluar me Nr.4102-Prot, më datë 08.05.2026, në lidhje me shqetësimin tuaj si banor i Pallatit për aromat e ardhura nga kuzhina si dhe erën e fortë të gazit nga vendosja e bombolave të GLN në ambjentet e biznesit "Byrektore" ju bëjmë me dije se:<br>Nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial më datë 12.05.2026 në orën 08:15, u gjetën të instaluara dy bombola gazi (Gaz i Lëngshëm i Naftës) me kapacitet rreth 15 kg secila, të kolauduara, me sensor të pranisë së gazit (Gaz i Lëngshëm i Naftës) dhe sistem automatik të bllokimit, të vendosura në ambjentin e brendshëm të cilat furnizjonë me (Gaz i Lëngshëm i Naftës) furrat e pjekjes.<br>Nga ana e inspektorëve nuk u konstatua asnjë rrjedhje ose prani e gazit (GLN) brënda ambjenteve të subjektit.<br><br>Në zbatim të Ligjit Nr. 32, datë 24.03.2016, " Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve nen Presion", VKM-të Nr.212, datë 16.03.2016, "Për Përcaktimin e Kushteve dhe të Rregullave Teknike për Përpunimin e Bombolave të mbushura me GLN është e lejuar vendosja e dy bombolave me kapacitet total deri në 30 kg brenda volumit të këtij ambjenti, si dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor dhe teknik për distanca të detyruara nga objektet përreth.<br>Subjekti ka kontratë furnizimi me GLN<br>Subjekti u informua për detyrimin ligjor mbi sigurimin civil ndaj palëve të treta dhe menjëherë u pajisë me kontratë sigurimi të përgjegjësisë civile ndaj palëve të treta<br>Subjektit ju la dertyrë për kryerjen e disa ndryshimeve teknike për rritjen e shkallës së sigurisë së impjantit të GLN.<br><br>Përsa më sipër ju informojmë se ISHTI është Institucioni që ndjek dhe kontrollon sigurinë e instalimit, shfrytëzimit si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të instalimeve të GLN por nuk ka asnjë kopetencë në lidhje me aromat, shkarkimin e tymrave, etj që çlirohen nga kuzhinat.<br>Institucioni ynë është i gatshëm në çdo moment në sektorët që mbulon, të kontrollojë dhe verifikojë çdo shkelje për kushtet teknike-ligjore. | E plotë | 0 |
| **6** | 12.05.2026 | Ju drejtojme kete kerkese per sqarim duke ju pyetur nese nje subjekt tregtues me shumice mundet te magazinoje ne nje moment te caktuar ne depozitat e veta me shume produkt sipas kategorise perkatese ne depozitat e tij. Per shembull mendojme se subjekti ka te miratuar me vertetim teknik depoziten A me kapacitet 50 ton per mazut, dhe depoziten B me kapacitet 100 ton per gazoil. A mundetr ky subjekt te mbaje produkt mazut 100 ton 50 ne depoziten A dhe 50 ne depoziten B? A i lejohet ndryshimi i destinacionit depozitave pa bere ndryshimet ne vertetim teknik dhe pa pasqyruar ndryshimet? A lejohet mbajtja e sasive me te medha ne depozitat e vete subjektit (jo pale te treta) nga sasia qe parashikon ne vertetimin teknik? | 18.05.2026 | Në përgjigje të kërkesës Tuaj me email, ku kërkohet sqarim në lidhje me kapacitetet e shoqërive të tregtimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të tyre ju informojmë si më poshtë:<br><br>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligji nr. 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre.<br>Pajisja me licencë e subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën hidrokarbure bëhet në zbatim të Vendimit Nr.970, datë 2.12.2015 " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve te saj".<br>Lidhur me kërkesën tuaj, nëse një subjekt tregtues me shumicë mundet të magazinojë në një moment të caktuar në depozitat e veta më shumë produkt sipas kategorisë përkatëse ju bëjmë me dije se: Në rastin e licencimit të disa kategorive produktesh hidrokarbure, ndarja e kapaciteteve sipas produkteve të jetë e pasqyruar në Vërtetimin teknik për respektimin e normave e kushteve teknike.<br>Vërtetimi teknik për respektimin e normave e kushteve teknike lëshohet nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj".<br>Vërtetimi teknik përmban kategorinë e produktit, numrin e rezervuarit, kapacitetin depozitues dhe afatin e vlefshmërisë.<br>Në lidhje me kërkesën tuaj, a i lejohet ndryshimi i destinacionit depozitave pa bërë ndryshimet në vërtetim teknik, bëjmë me dije se në Vërtetimin Teknik janë të përcaktuar për çdo rezervuar edhe kategoria e produktit të tregtimit.<br>Lidhur me mbajtjen e sasive më të mëdha në depozitat e vetë subjektit, informojmë se sasia e produktit është përcaktuar në Vërtetim Teknik si kapacitetin depozitues. | E plotë | 0 |
| **7** | 14.05.2026 | Dua të denoncoj nje rast flagrant të një personi që transporton dhe tjetërson bombola C20 gazi jashtë cdo lloj kriteri dhe bëhet rrezik për qytetarët. | 21.05.2026 | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.99/2024, datë 12.9.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 32/2016 dt 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion ", VKM-të Nr. 212 datë 16.03.2016, "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me GLN", VKM Nr.1062 datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për paisjet dhe bashkësitë nën presion", Urdhërit të Ministrit Nr. 184 datë 05.07.2005 "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".<br>Në përgjigje të ankesës tuaj Nr.4245-Prot më datë 14.05.2026, ardhur pranë ISHTI, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për verifikim është marrë në konsideratë nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe nga verifikimet e kryera deri tani na rezulton se të dhënat e dërguara prej jush janë të pa mjaftueshme për të bërë të mundur gjetjen e të dhënave të sakta të subjektit në fjalë.<br>Megjithatë inspektorët e ISHTI do e ndjekin dhe në vazhdim këtë çështje për të identifikuar dhe kontrolluar këtë subjekt dhe do ju informojmë sapo të jetë i mundur verifikimi i tij.<br>[illegible] | E plotë | 0 |
| **8** | 18.05.2026 | Ju drejtojme kete kerkese per informacion lidhur me nenin 12 te ligjit nr.8450 i ndryshuar pikat 4 dhe 5 ku thuhet:<br><br>4. Rafineritë e naftës kanë të drejtë t'i shesin prodhimet e tyre në vend, te shoqëritë e tregtimit me shumicë e impiantet e përpunimit, si dhe t'i eksportojnë në shtete të tjera.<br>5. Rafinerive te naftës u ndalohet te lidhin çfarëdo marrëveshje për furnizim te drejtpërdrejtë te stacioneve te shitjes se karburanteve, te njësive te shitjes se lendeve djegëse, te shoqërive qe tregtojnë me pakice apo shoqërive te papajisura me leje, sipas përcaktimeve te këtij ligji.<br><br>Kerkojme informacion nese rafinerive u lejohet shitja direkt drejt konsumatoreve te medhenj apo cdo konsumatori (pa kaluar nga tregtuesit me shumice) si dhe nese shitja e tille perben shkelje administrative sipas nenit 25 pika 1 germa c | 22.05.2026 | "Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion lidhur me interpretimin e nenit 12, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, Ju bëjmë me dije sa më poshtë:<br>Neni 12 pika 4 e ligjit parashikon se rafineritë e naftës kanë të drejtë t'i shesin prodhimet e tyre në vend te shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe impiantet e përpunimit, si dhe t'i eksportojnë në shtete të tjera. Ndërsa pika 5 e po këtij neni ndalon lidhjen e marrëveshjeve për furnizim të drejtpërdrejtë të stacioneve të shitjes së karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse, shoqërive që tregtojnë me pakicë apo subjekteve të papajisura me lejet/licencat përkatëse sipas përcaktimeve të ligjit.<br>Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara rezulton se ligji ka përcaktuar një ndarje të veprimtarisë ndërmjet rafinerive të naftës dhe subjekteve që ushtrojnë tregtimin me shumicë apo pakicë të nënprodukteve të naftës.<br>Sa i përket shitjes së drejtpërdrejtë nga rafineritë te konsumatorët fundorë apo konsumatorët e mëdhenj industrialë, dispozitat e mësipërme nuk përmbajnë një parashikim të shprehur specifik për këtë kategori subjektesh. Për rrjedhojë, vlerësimi i çdo rasti konkret duhet të kryhet në raport me statusin ligjor të subjektit përfitues, pajisjen me licencat/lejet përkatëse, natyrën e veprimtarisë së ushtruar, si dhe respektimin e kërkesave të parashikuara nga ligji nr. 8450, i ndryshuar.<br>Në rastet kur nga organet kompetente konstatohet ushtrim veprimtarie apo furnizim në kundërshtim me kufizimet dhe kërkesat e përcaktuara nga ligji nr. 8450, i ndryshuar, zbatohen masat administrative të parashikuara në nenin 25 të këtij ligji, sipas rastit konkret të konstatuar." | E plotë | 0 |
| **9** | 26.05.2026 | Jam nje qytetar nga vlora dhe jam duke hapur nje restorant dhe me nevojitet te vendos bombol gazi 1000 Litra.<br><br>Kerkoj nga ana juaj se cfare lloj dokumentacioni me duhet ne kete rast. | 26.05.2026 | Nga ana e drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve nën Presion është vënë nëdispozicion informacioni I kërkuar | E plotë | 0 |